

**SHENIME PER
PASQYRAT FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2018**

Informacion i pergjithshem.

Statusi i shoqerise.

Shoqeria Ujesjelles-Kanalizime Gjirrokaster sha eshte regjistruar me Vendim te Qendres Kombetare te Regjistrimit, date 14/06/2005, me veprimtari kryesore : Prodhim dhe shitje uji te pijshem, subjekte shtetore subjektet qe veprojne ne Qytetin e Gjirrokastres si dhe mirembjaten e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza per kete qytet me Seli ne adresen: Zona Industriale, Rruga Muhebin Muco, godine 1-kateshe , zona kadastrale 8543, nr pasurie 20/12. Shoqeria eshte regjistruar prane organeve tatimore me NIPT K43522604G.

POLITIKA TE RENDESISHME KONTABILE.

Politikat kontabile te ndjekura ne respektimin e cheshtjeve te cilat jane konsideruar materiale ne rezultatin vendimtar te vitit dhe ne paraqitjen e situates financiare te shoqerise si me poshte :

Bazat e pergatitjes.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne perputhje me Ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat Financiare jane te raportuara me monedhen vendase ("LEKË"), qe eshte edhe monedha funksionale e shoqerise.

Shpjegime.

Mjetet monetare.

Aktivitet monetare ne : arke dhe banke, leke llogari rrjedhese dhe pasivete financiare, overdraftet bankare maten fillimisht me vleren e drejte (domethene me kosto) plus koston e transaksioneve. Ne paraqitjen e tyre ne bilanc ne fund te vitit ushtrimor vleresohen dhe paraqiten me vleren e tyre te drejte.

Paraja dhe ekuivalentet e parase jane te perfshira ne gjendjet e parase si dhe depozitat e saj qe jane te pagueshme me kerkese, jane te perfshira si nje komponent i parase apo ekuivalenteve te tjera me qellim te pasqyres se flukseve te parase.

Instrumentat financiare:

Aktivitet financiar (me perjashtim te qirave financiare) dhe pasivete financiare si instrumenta financiare do te maten fillimisht me vleren e drejte (domethene me kosto) plus koston e transaksioneve, qe jane direkt te atribueshme blerjes ose emetimit te instrumenteve financiare. Kostoja e nje aktivi dhe pasivi financiar, eshte pagesa e te cilit kryhet menjehere me para ne dore, eshte vlere nominale e shumes se arketuar (paguar).

Investime te tjera financiare.





Investimet financiare ne formen e qirave financiare dhe investimeve te tjera te ngjashme, maten dhe do te paraqiten ne bilanc ne fund te vitit ushtrimor sipas kontratave te lidhura dhe specifikave te tyre

Inventaret.

Inventaret (pa perfshire parapagesa per furnizime) maten fillimisht me kosto. Kosto e inventareve perfshin: koston e te gjitha materialeve, te lidhura drejteperdrejte me prodhimin, si dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Pas njohjes fillestare te inventareve, njesia ekonomike raportuese vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Kostoja do te matet me metoden e : a. identifikimit

Vlera neto e realizueshme i referohet vleres neto qe njesia ekonomike raportuese pret te perfitoje nga shitja e inventarit, ne rrjedhen normale te biznesit.

Investime financiare afatgjata materiale.

Kerkesat per t'u arketuar afatgjata. Ne kete post paraqiten huate e dhena nga organizata te treteve si dhe llogari te tjera te arketueshme afatgjata nga te tretet (klienta, debitore, etj.). Kerkesat per t'u arketuar afatgjata duhet te maten fillimisht me vleren e caktuar drejtesisht. Pas njohjes fillestare te tyre, organizata i regjistron keto kerkesa per t'u arketuar afatgjata ne bilanc me kosto te amortizuar (duke marre ne konsiderate normen e interesit efektiv dhe nominal)

Aktive Afatgjata Materiale.

AAM maten fillimisht me kosto. Kosto e AAM perfshin: koston e blerjes si dhe kosto te tjera te drejteperdrejte.

Percaktimi i koston se AAM, te marra nga grandet qeveritare behet ne perputhje me SKK 10.

Percaktimi i koston se AAM, te marra me qera financiare behet ne perputhje me SKK 7.

Percaktimi i koston se AAM, te perfituara nga kombinimi i bizneseve do te behet ne perputhje me SKK 9.

Vleresimi i mepasshem behet me :

a- politiken kontabel ose modelin e koston(vlera kosto - amortizmin e akumuluar - ndonje humbje e akumuluar nga zhvleresimi).

b- politiken kontabel ose modelin i rivleresimit (vlera e drejte ne daten e rivleresimit - amortizmin e akumuluar te mepasshem - humbjet e akumuluar te mepasshme nga zhvleresimi).

Amortizimi i AAM llogaritet mbi bazen mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe instalimet dhe mbi bazen e vleres se mbetur per makineri e pajisje, pajisjet e zyres dhe mjetet e transportit me normat e meposhtme per vitin 2015

Ndertesat	5%
Instalimet teknike (Linja)	5%
Makineri e Pajisje	20%
Pajisje informatike	25%
Mjete transporti	20%

AAJM maten fillimisht me kosto. Kosto e AAJM llogaritet si AAM.

Percaktimi i koston se AAM, te marra nga grandet qeveritare do te behet ne perputhje me SKK 10.

Vleresimi i mepasshem behet me: politiken kontabel ose modelin e koston (vlera kosto - amortizmin e akumuluar - ndonje humbje e akumuluar nga zhvleresimi).

Amortizimi i AAJM llogaritet ne menyre lineare sipas viteve te percaktuara ne kontrate por jo me shume se 5 vjet.

Aktive te tjera afatgjata. Ne kete post paraqiten :

Elemente te AAM dhe AAJM qe priten te shiten permbi 12 muaj nga data e mbylljes bilancit kontabel (llog.25 AA te mbajtura per shitje), riklasifikohen si aktive afatgjata te mbajtura per shitje dhe paraqiten ne postin aktive te tjera afatgjata. Ato vleresohen me vleren me te ulet midis vleres se tyre kontabel dhe vleres se tyre se drejte minus kostot e shitjes, dhe paraqiten me vete ne bilanc.

Elemente te AAM per aktivite jo te vijueshme (te nderprera), vleresohen me kosto.

AAM ne proces vleresohen me kosto.

Provizionet.

Njohja e provizionit:

Nje provision njihet ne bilancin kontabel kur shoqeria ka paraqitur nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluar, dhe eshte e mundur nje fluks daljesh i perfitimeve ekonomike per permbytjen e detyrimit.

Shoqeria do te njohe provizionin ne bilancin e saj vetem kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese (detyrim ligjor, konstruktiv dhe alternativa e vetme eshte shlyerja e ketij detyrimi) ka ndodhur pas dates bilancit.

Ne cdo date te bilancit, drejtimi vlereson domosdoshmerine per krijimin e provizioneve te reja dhe rivleresimin ose anulimin e provizioneve ekzistuese.

Ne kete post paraqiten detyrimet afatshkurtra-Provizionet Afatshkurter per te cilat shoqeria nuk ka siguri te plote ne lidhje me daten dhe shumen e shlyerjes se detyrimit brenda 12 muajve, por qe mund te vleresohen ne menyre te besueshme.

Provizionet afatgjata do te njihen ne bilanc me vleren aktuale (norma e skontimit do te jete norma e interesit te tregut) te shpenzimeve te pritshme, pervec rastit kur efekti i skontimit eshte jomaterial. Ne kete post paraqiten detyrimet afatgjata-Provizionet Afagjate per te cilat organizata nuk ka siguri te plote ne lidhje me daten dhe shumen e shlyerjes se detyrimit pas me shume se 12 muaj nga data e mbylljes bilancit, por qe mund te vleresohen ne menyre te besueshme.

Njohja e te ardhurave / shpenzimeve.

Njohja e te ardhurave.

Te ardhurat do te njihen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme. Shuma e te ardhurave, qe rrjedhin nga nje transaksion, percaktohet zakonisht me nje marreveshje mes organizates (shitesit) dhe bleresit te sherbimeve (ose perdoruesit te aktivitetit). Te ardhurat vleresohen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e skontimeve ose rabatat e ofruara per volumen e shitur, siç specifikohet ne kontrate.

Te ardhurat perfshijne vleren e faturave (duke i zbritur: tvsh, zbritjet e cmimit dhe kthimet) per shitjen apo ofrimin e sherbimeve. Te ardhurat do te njihen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme. Arketimet jane kryer ne menyre te arsyeshme dhe priten te arketohen diferencat e mbetura.

Te ardhurat ashtu edhe shpenzimet e shoqerise per vitin ushtrimor raportues jane kontabilizuar sipas metodës se konstatimit te te drejtave dhe detyrimeve, qe do te thote se kontabilizimi eshte bere ne momentin kur transaksioni ekonomik ndikon mbi aktivet neto te shoqerise, dhe jo ne momentin e hyrjes ose daljes se parave qe shoqerojne transaksionin.

Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet do te njihen me vleren e drejte te shumes se paguar ose te pagueshme. Shuma e shpenzimeve, qe rrjedhin nga nje transaksion, percaktohet zakonisht me nje marreveshje mes organizates (bleresit) dhe shitesit te mallrave ose sherbimeve (ose perdoruesit te aktivitetit).

Te ardhurat / shpenzimet financiare.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane bere te njohura si te ardhura dhe shpenzime ne pasqyren e te ardhurave sipas rrjedhjes tyre.

Rivleresime dhe provizione per AAM.

Nuk jane kryer rivleresime dhe provizione per AAM.

Monedhat e huaja .

Veprimet ne valuta te huaja kthehen ne ("LEKË") e regjistrohen me kurset e kembimit te dates se veprimit/ transaksionit. Diferencat e realizuara nga luhatja e Lekut shqiptar ("LEKË") dhe kurseve te kembimit regjistrohen ne daten e mbylljes se bilancit. Diferencat e realizuara nga luhatja e kurseve te kembimit regjistrohen si ze ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per gjendjet ne monedhe te huaj ne fund te vitit te arkes dhe bankes.

Kontratat e mallrave te destinuar per perdorim vetiak.

Shoqeria nuk perdor mallra per nevojat e veta me qellim prodhimi, konsumi etj.

Qiradhenie financiare.

Qirate financiare vleresohen ne njohjen e tyre fillestare si detyrime, sipas rregullave te percaktuara. Paraqitja ne bilanc si detyrime afatgjata do te behet e vleresuar me koston e amortizuar. Keto detyrime do te paraqiten se bashku me shumen e interesit te maturuar por ende te papaguar.

Shoqeria nuk ka kontrata qiradhenie financiare.

Qiradhenie operacionale .

Shoqeria nuk ka kontrata qiradhenie operacionale.

Ngjarjet pas dates se bilancit kontabel .

Shoqeria nuk ka ngjarje te ndodhura pas dates bilancit kontabel.

Asetet dhe detyrimet do te pershtateshin per ngjarjet (nese do te kishte) qe rrjedhin midis dates mbylljes bilancit kontabel dhe dates aprovimit te pasqyrave financiare nga Drejtimi, ne rastin kur keto ngjarje sigurojne informacion shtese per vleresimin e shumave qe lidhen me ngjarjet ekzistuese ne daten e bilancit ose nenkuptojne parimin e vijimesise ne relacionin e pjeseve ose teresine e grupit.

SHENIME PER ZERAT (ELEMENTET) E PASQYRAVE FINANCIARE KRYESORE.

Te ardhurat

Te ardhurat jane realizuar sipas te dhenave ne tabelen e meposhtme :

<i>Te ardhurat</i>	
<i>Te ardhura nga shitja Mallrave</i>	106.393.600

Te ardhurat kryesore te shoqerise jane nga Uji i pijshem . sherbimi i kanalizimeve (ujrat e ndotura dhe tarifa e sherbimit per Bashkine Gjriokaster dhe korespondojne me deklarate librit te shitjeve per vitin 2018, dhe analitikisht si me poshte:

1. Te ardhura nga Uji i pijshem ne shumen 71.558.011 leke.

2. Te ardhura nga sherbimi i kanalizime ne shumen 8.920.090 leke.
3. Te ardhura nga Tarifa e Sherbimit ne shumen 9.531.880 leke.
4. Te ardhura nga Uji i Pijshme per Njesite Administrative ne shumen 16.383.629 leke.

Te ardhura te tjera jane te ardhura nga veprimtarite e tjera te shoqerise :

5. Te ardhura nga kontrata te reja ne shumen 2.100.238 leke.
6. Te ardhura nga kamat-vonesa ne shumen 1.985.260 leke.
7. Te ardhura nga vendosje matesi ne shumen 861.372 leke.
8. Te ardhura nga Interesa Bankare ne shumen 2253 leke.
9. Te ardhura nga mbyllke kontrate ne shumen 58.800 leke.
10. Te ardhura si Agjent Tatimor ne shumen 2.884.834 leke.
11. Te ardhura te tjera ne shumen 565.139 leke. (Kaluan ne llogarine e shoqerise nfa SETEC pas auditimit nga KLSH pasi te ardhurat e krijuara nga shitja e dokumentit te tenderit nga faza e pare duket ti kalojne shoqerise.
12. Te ardhura nga Buxheti i Shtetit (Suvvencione) ne shumen 7.819.907 leke, sipas shkreses e ardhura nga Ministria e Financave me Nr 18124/3 date 14.12.2018.
13. Te ardhura nga Rimarrja ne shumen 6.125.000 leke.

Totali i te Ardhurave per vitin 2018 eshte 128.796.381 leke.

Kosto e mallrave te shitura

Kostoja e mallrave te shitura eshte e perbere nga shuma e vleres se mallit ne fature plus shpenzimet e transportit dhe magazinimit dhe gjithë kostot e tjera te drejtperdrejta deri me mberritjen e artikujve ne magazine. Per shoqerine “ Ujesjelles-Kanalizime Gjrokaster sha ” kostoja e mallrave te shitura eshte ne shumen 7.988.549 leke .

Kosto e stafit

Kosto e stafit eshte vetem paga dhe sigurime shoqerore si edhe shperblime dhe honorare per te cilat eshte mbajtur tatim ne burim bazuar ne ligjin mbi te ardhurat personale.

<i>Kosto e punes</i>	
<i>Paga personeli</i>	64.441.909
<i>Sigurime shoqerore</i>	10.763.419

Amortizimi dhe zhvleresimet

Perfaqesohet nga amortizimi i akumuluar i makinerive dhe pajisjeve ekzistuese si dhe amortizimi i llogaritur per shtesat e bera gjate vitit ushtrimore 2018 sipas tabelës se amortizimit bashkangjitur pasqyrave financiare te shoqerise.

<i>Amortizimi dhe zhvleresimet</i>	18.148.500
<i>Amortizimi nga rivleresimi i aseteve</i>	80121185

Rivleresimi i Aseteve per Shoqerine Ujesjelles-Kanalizime Gjirokaster u krye nga NOVATECH STUDIO.(Urdher Prokurimi Nr 117/1 date 27.11.2018

Proces-Verbali i marrjen ne dorezim u krye ne daten 03.01.2019 nga Komisioni i meposhtem :

Z.Kristaq Jorgaqi me detyre Inxhinier prane Drejtorise Teknike

Z.Arqile Puleri me detyre Inxhinier prane Drejtorise Teknike

Znj.Refaela Jaupi me detyre Financiare prane Drejrorise Tregtare.

Shpenzime te tjera

Tek shpenzime te tjera perfshihen shpenzimet e nevojshme qe ka shoqeria per ushtimin e aktivitetit te saj te cilat ne menyre te detajuar jepen ne tabelen e meposhtme:

<i>Telefon, Fax, shpenzime interneti</i>	251.931
<i>Energji, Uje, gaz i lengshem</i>	12.443.556
<i>Udhetim e Djeta</i>	775.000
<i>Te tjera tatime taxa</i>	136.000
<i>Shpenzime QERAJE</i>	875.700
<i>Shpenzime sherbime nga te trete (eks kontabel, shrsf)</i>	882.000
<i>Shpenzime te tjera</i>	829.019
<i>Blerje te pastokueshme</i>	7.988.549
<i>Shpenzime Sig Automejtesh</i>	161.093.
<i>Shpenzime per Taska Automejtesh</i>	66.645
<i>Shpenzime riparime /mirembajtje Aurometesh</i>	579.400
<i>Shpenzime Media</i>	160.500
<i>Shpenzime te tjera personeli</i>	6.414.793
<i>Shpenzime Amortizimi nga Rivleresimi I Aseteve Njesi aAdn</i>	80.121.185

Shpenzime financiare

Jane shpenzime te cilat perbehen nga zerat kryesore te cilat jepen te shpjeguar me poshte:

<i>Shpenzime dhe Te ardhura</i>	
---------------------------------	--



<i>financiare</i>	
<i>Shpenzime per gjyqe personeli te larguar nga puna</i>	1.701.992
<i>Komisione Bankare</i>	49..160

Totali i Shpezymeve eshte ne shumen 126.669.167 leke por duke perfshire edhe Amortizimi nga Rivleresimi i Aseteve te Njesive Adm shkon ne shumen 206.790.351 .Duke marre ne analize kete te fundit Shoqeria rezulton me humbje ne vleren 77.993.970 leke.

Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet monetare.

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, gjendjet e aktiveve monetare ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur me vleren e drejte. Kjo vlere rezulton ne shumen totale prej 18.027.452 Leke dhe perbehet nga :

	Bankat	Nr. I llogarise	Gendja ne leke
1	Tirana Banka	400-301345-101	1.296.079
2	Alpha Bank	0000-294071	1.091.769
3	BKT	409042200	1.792.930
4	Banka Intesa San Paolo	000-931101	21.655
5	Banka Societe General Albania	00000-219078	8366
6	Abi Bank	000-346019	4.901.887
7	NBG	17844510000018	5.346.078
8	Raiffaisen Bank	008122753	1.383.224
9	Credins Bank	00000397694	2.177.959

Arka ne leke ne shumen 7505 leke.

Veprimet ne valuta te huaja kthehen ne LEK e regjistrohen me kurset e kembimit te dates se veprimit / transaksionit. Diferencat e realizuara nga luhatja e kurseve te kembimit regjistrohen ne daten e mbylljes se bilancit. Diferencat e realizuar nga luhatja e kurseve te kembimit regjistrohen si ze ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per gjendjet ne monedhe te huaj ne fund te vitit ushtrimor te aktiveve monetare (arke, banke etj.).

Derivativet dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim. N/A

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim.

Te drejta te Arketueshme

Gjendjet e aktiveve te tjera financiare afatshkurtra, ne fund te vitit ushtrimor jane vleresuar dhe paraqitur me vleren nominale te shumes per t'u arketuar dhe perfaqesohen nga tabela e meposhtme:

<i>Aktive te tjera financiare afatshkurtera</i>	
<i>Kliente per mallra, produkte e sherbime</i>	106.866.052

Zeri "Kliente" ne shumen totale prej 106.866.052 leke perbehen nga klientet per fatura te papaguara sipas kategorive te klienteve si me poshte ku vihet re se 95 % jane Konsumator Familjar ne Shumen 101.522.749 leke.

Privat ne Shumen 2.137.322 leke.

Institucione Shteteroe ne Shumen 3.205.981 leke.

Shteti debitor per tatim fitimin

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka parapagime per tatim fitimin Shumen 378.473leke.

Inventari.

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor inventar ne Shumen 3.782.763 Leke eshte pasqyruar edhe ne pasqyren e rezultatit per vitin ushtrimor sipas Urdhrin nr 01 , date 03.01.2019 i Administartorit te shoqerise ne zbatim te Ligjin 10296 te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Udhezimit nr 30 date 27.12.2011 te Ministrise se Financave.

Per pajisje dhe artikujt amballazhues per kantina sipas listes bashkelidhur.

Aktive biologjike afashkurtra. N/A

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aktive biologjike afashkurtra.

Aktive afatshkurtra te mbajtura per shitje. N/A

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aktive afatshkurtra te mbajtura per shitje.

Parapagime dhe shpenzime te shtyra.

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Parapagime per inventare dhe furnizime.

AKTIVET AFATGJATA

Investime financiare afatgjata materiale. N/A

Aktive afatgjata materiale.

Gjendjet e tyre ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur dhe vleresuar me modelin e koston (vlere kosto - amortizmin e akumuluar - ndonje humbje e akumuluar nga zhvleresimi),

<i>Investime afatgjata materiale</i>	
<i>Rrjet Ujor</i>	243.581.720
<i>Ndertime</i>	71.480.336
<i>Toke</i>	3.601.095
<i>Instalime Teknike</i>	1.225.733
<i>Mjet Transporti</i>	14.194.505
<i>Paisje Inf</i>	1.123.373
<i>Paisje Zyre</i>	580129
<i>Kuz</i>	10.086.788
<i>Inv Ekonomik</i>	1.663.266
<i>AAM te Patrupezuar</i>	10.87756

Totali i Aktieve afatgjata materiale eshte ne shumen 348.624.701 leke.

Per vitin 2018 megjithese jane realizuar investime per Aktive afatgjata materiale ne shumen 5.372.782.04 EURO (sipas proces verbalit te firmosur nga ish Administratori ne detyre z. BASHKIM TOLA date 28.02.2018 me nr prot 635 dhe ardhur ne Drejtorine Tregtare ne daten 08.02.2019)sepse nuk ishte cikluar ne destinacionin perkates pra ne Drejtorine Tregtare (Sektori i Finances) ,menjehere u ngrit Urdhri per Identifikimin analitik te Investimit te mesiperm (Urdhri nr 28 date 08.02.2019 ku ngarkohet komisioni si me poshte:

Z.Bashkim Tola ne cilesine e personit qe ka marre ne dorezim Projektin Infrastruktura Bashkiake I dhe II.

Znj.Çelestina Dajlani me detyre Inxhinier ne Drejtorine Teknike,

Znj.Reafela Jaupi me detyre Financiere ne Drejtoria Tregtare.

Procesi i identifikimit vazhdon .

Per kete arsye keto asete nuk jane perfshire ne Pasqyrat Financiare te vitit 2018.

Aktive biologjike afatgjata. N/A

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aktive biologjike afatgjata.

Aktive afatgjata jomateriale.

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor aktive afatgjata jomateriale.



Aktive te tjera afatgjata. N/A

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor aktive te tjera afatgjata.

PASIVET AFATSHKURTRA

Derivativet. N/A

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor derivative.

Huamarrjet

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor nuk ka huamarrje afatshkurtra.

Huate dhe parapagimet.

Gjendjet e huave dhe parapagimeve te poshteshenuara ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur me vleren nominale te shumes per t'u paguar.

<i>Detyrime Afatshkurtra per:</i>	
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit (furnitore)</i>	12.686.621
<i>Te pagueshme per Sigurimet Shoqerore, e Shendetesore+ TAP</i>	2.662.051
<i>Te pagueshme per TVSH</i>	956.105
<i>Te pagueshme per Tatim Fitimin</i>	1.503.219
<i>Te pagueshme per Tatimin ne Burim</i>	860.931

Te pagueshme ndaj furnitorëve eshte ne shumen 12.686.621 Leke.

Detyrime per sigurimet shoqerore e shendetesore te cilat rezultojne ne shumen 2.662.051 Leke jane detyrime dhjetor 2018 ne shumen 1.708.608 leke dhe detyrime te prapambetura ne shumen 953.443 leke.

Detyrime per TVSH te cilat rezultojne ne shumen 956.105 leke jane detyrime dhjetor 2018 ne shumen 886.298 leke dhe detyrime te prapambetura ne shumen 69807 leke.

Te tjera tatime e taksa perfaqesohen nga tatimi ne burim i te ardhurave nga qiraje ne shumen 860.931 Leke jane detyrime dhjetor 2018 ne shumen 842.431 leke dhe detyrime te prapambetura ne shumen 18.500 leke.

Te tjera detyrime per Tatim –Fitime te cilat rezultojne ne shumen 1.503.219 leke jane detyrime te mbartura ne shumeb 1.124.746 leke paguar gjate vitit 2018 ne shumen 378.473 leke.

Te tjera te Pagueshme / Debitore dhe kreditore te tjere

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria e ka gjendjen e llogarise Debitore e kreditore te tjere ne shumen 4.640.646 Leke dhe perfaqesohen nga shuma e papaguar ndaj te treteve per qirate e ambjenteve.

Te ardhura te shtyra (grante)

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka gjendje Grante dhe te ardhura te shtyra ne fund te vitit ushtrimor ne shumen 8.597.586 leke

Detyrime Afatgjata

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster sha ka nenshkruar ne vitin 2017 nje kredi dhe granti financuar nga KFW dhe EU per investime dhe konsulencë në shumën 5 372 782 euro.

Investimi eshte eshte regjistruar cdo vit ne pasqyrat financiare sipas metodës së realizimit dhe marrjes në dorëzim të investimit dhe kryerjes së shërbimeve.

Kjo kredi fillon të shlyhet në vitin 2022.

Rezerva Rivleresimi

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka gjendje rezerva rivleresimi ne fund te vitit ushtrimor ne shumen 13.632.816leke.

Rezerva te tjera

Ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka gjendje rezerva te tjera ne fund te vitit ushtrimor ne shumen 370.557.963 leke qe perfaqesohen nga vlera e Aseteve afatgjata materiale te marra nga Njesite Administrative.

Fitimi i vitit financiar

Ne aktivitetin e saj sipas te zakonshem per vitin 2018 shoqeria rezulton me fitim ne Shumen 2.127.214 leke. Duke qene se Aktivet afatgjata materiale te marra ne dorezim nga procesi Rivleresimit , iu nenshtruan rivleresimit per vitin 2018 rezulton nje humbje financiare ne Shumen 77.993.970 leke.

Si rrjedhoje ne pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2018, shoqeria ka rezultuar me Humbje ne fund te vitit ushtrimor ne shumen 77.993.970 leke.

Administratori i shoqerise

Dhimiter KRISTIDHI



Drejtor Tregtar

Marsela Osmenllari